5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Vjelje grumbullim i degezave te xines ne territorin e Bashkise Polican” me sasi te degezave te xines 736 kv (te pasqyruara ne tabele, ne parcelat

Ekonomia Pyjore	Parcela ku eshte instaluar xina	njesia	sasia
Guak Polican	111;112	kv	144
Mali Terpan	32/b; 33/b,c; 38/b	kv	212
Hija e Roshnikut	41/a; 42/a; 44/b	kv	380

6. Vlera fillestare e ankandit eshte 73 600(shtatedhjete e tre mije e gjashteqind leke)pa TVSH
7. Sasia 736 kv (shtateqind e tridhjete e gjashte) kv
8. Kriteri I vleresimit: Çmimi me I larte.
9. Vendi i zhvillimit te ankandit: Bashkia Poliçan,
10. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje; 02.11.2020 ora 11:00
11. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund te trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo
Nëse Po			
Monedha	leke	Çmimi	1000(njemije)

Dokumentet standarde te ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimit te njoftimit te fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit te Vlerësimit te Ofertave.

13.Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.

ALBKROM SH.A.
NJOFTIM ANKANDI

ALBKROM sh.a. (në likuidim e sipër) Tiranë, mbështetur në Udhëzimin Nr. 5380, datë 20.07.2011 të ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shpall ankandin me procedurë të hapur, “Faza e Tretë,” për shitjen e STERILEVE TE KROMIT ME VENDNDODHJE NE GALERINE NR 1 DHE GALERINE NR 2 , SELISHTE, NJESIA BULQIZE-BATER, si më poshtë:

Nr	EMËRTIMI	Sasia ne ton	Cilesia (%) Cr2O3	Cmimi (Lek/Ton)	Shuma (Lek) pa TVSH
1.	Stoku Nr 1, Galeria Nr 1	11.250	6.21%	149,8	1.685.250
2.	Stoku Nr 2, Galeria Nr 2	19.800	6.21%	149,8	2.966.040
	Totali	31.050			4.651.290

Hapi i ankandit do te jete 2 - 5% te vlerës se ofertës me te lartë, i cili do te vendoset nga Komisioni i ankandit, ditën e zhvillimit .

Dokumentat e ankandit do te terhiqen prane Albkrom sh.a. (ne likuidim e siper) me adrese Blloku Vasil Shanto, mbrapa ish KESH Tirane, cdo dite nga e Hena ne te Premte prej ores 10.00 deri 14.00 kundrejt pageses prej 2000 lekë.

Informacione të tjera plotësuese për ankandin mund të merren në të njejtën adresë.

Ankandi do të hapet në datën 12.11.2020 ora 10:00, në zyrat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomise, në adresën “Bulevardi Dëshmorët e Kombit“ Tiranë, në prani të blerëseve Lloji i procedurës standarte të ankandit do të jetë: Procedur e Hapur.

Afati i fundit për dorzimine dokumentacionit, për pjesëmarrje në ankand do të jetë në orën 10-00, të datës 12.11.2020.

Kushte e kualifikimit

IV.PJESEMARRJA DHE KUALIFIKIMI

Dokumentat qe duhet te paraqiten

Çdo subjekt fizik apo juridik apo individ do të paraqes në ankand

IV.1 Persona Juridike / Fizike

- a. Kërkesën për blerje.
- b. Formularin e ofertës të plotësuar me shumen dhe vlefshmerine e kerkuar ne DS te Ankandit, te firmosur dhe vulosur me te gjitha gjeneralitetet.
- c. Formularin e sigurimit të ofertës lëshuar nga Banka, për pagesën e 2 % të vlerës fillestare të mallit të kërkuar.
- d. Ekstrakt Historik lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- e. Ekstrakt të Thjeshtë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- f. Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in
- g. Dokument identifikimi te administratorit (fotokopje e noterizuar)

- h. Mandat pagesën për blerjen e dokumentave të ankandit.
- i. Në mungesë të administratorit të shoqërisë për pjesëmarje në ankand, ky i fundit autorizon me prokurë të posaçme (bashkangjitur ID e noterizuar e perfaqesuesit me prokure) personin që do të marrë pjesë në ankand. I autorizuari duhet të jetë i pajisur me dokument origjinal të identifikimit.
- j. Vertetim qe verteton se subjekti nuk eshte ne proces falimentimi leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit
- k. Vertetim qe subjekti nuk eshte denuar per shkelje penale leshuar nga Gjykata
- l. Vertetim te Gjendjes Gjyqesore
- m. Vertetim qe subjekti nuk eshte ne ndjekje penale per nje nga veprat penale te permendura nga Neni 45, pika 1 e Ligjit per Prokurimet Publike.
- n. Vertetim nga administrata tatimore qe subjekti ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqerore
- o. Vertetim nga administrata tatimore qe subjekti ka paguar te gjitha detyrimet fiskale.
- p. Vertetim qe subjekti nuk ka detyrime ndaj Albkrom sh.a. (ne likujdim e siper) te leshuar nga Albkrom sh.a.

IV.2 Individe

- a. Kërkesën për blerje.
- b. Formularin e ofertës të plotësuar me shumen dhe vlefshmerine e kerkuar ne DS te Ankandit, te firmosur me te gjitha gjeneralitetet.
- c. Formularin e sigurimit të ofertës lëshuar nga Banka, për pagesën e 2 % të vlerës fillestare të mallit të kërkuar.
- d. Dokument identifikimi (fotokopje e noterizuar)
- e. Mandat pagesën për blerjen e dokumentave të ankandit.
- f. Vertetim qe individi nuk eshte denuar per shkelje penale leshuar nga Gjykata
- g. Vertetim te Gjendjes Gjyqesore
- h. Vertetim qe individi nuk eshte ne ndjekje penale leshuar nga prokuroria
- i. Vertetim qe individi nuk ka detyrime ndaj Albkrom sh.a. (ne likujdim e siper) te leshuar nga Albkrom sh.a.

Mungesa e njëjës prej dokumentave të cituar më sipër skualifikon kërkuuesin.

V.Specifikimet Teknike.

Janë të përshkruara në DS, “Shtojca” 9.

VI.Fiton ofertuesi qe ka vleren me te larte:

VII.Per fituesit

1. Fituesi i ankandit formularin e sigurimit te kontrates dhe kontraten I nenshkruan sipas Nenit 39 te Ligjit per Ankandet.Fituesi ankandit lidh kontraten per blerjen e mallit pas kryerjes se plote te pageses të mallit sipas vlerës së fituar në ankand duke shtuar dhe 20% e TVSH.
2. Në rast se brënda 30 ditëve, nga data e shpalljes fitues, nuk paguhet vlera e plotë e malli të kërkuar, pagesa prej 2% konfiskohet, gjithashtu , fituesi humbet të drejtën për të marrë pjesë në ankand që do të zhvillohet për rishitjen e këtyre mallrave.

3. Pjesemarrësi në ankand që terhiqet pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e mallrave të shpallura për shitje nuk i kthehet 2% I vlerës fillestare i ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand
4. Pjesëmarrësve të tjerë në ankand përveç fituesit ju kthehet 2% i vlerës fillestare i ngurtësuar paraprakisht.

Shenim:

Personat juridike apo fizike dhe individët të interesuar për blerjen e sterileve të kromit përpara se të paraqiten në ankand kanë të drejtën të verifikojnë vendndodhjen, sasinë dhe cilësinë e tyre

ALBKROM SH.A.
NJOFTIM ANKANDI

ALBKROM sh.a. (në likuidim e sipër) Tiranë, mbështetur në Udhëzimin Nr. 5380, datë 20.07.2011 të ish Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, shpall ankandin me procedurë të hapur, “Faza e Dytë,” (Ripërsëritje) për shitjen e MJETEVE TË TRANSPORTIT TË VLERESUARA PËR SKRAP NË NJESINË KLOS-BURREL, BULQIZË-BATER DHE TIRANË si më poshtë:

Nr	Emertimi mjetit	Targa për referencë	Sasia në kg	Cmimi lek/kg	Shuma Lek Pa TVSH
1	Mercedes Benz 190	TR 9535 H	934	27	25,218
2	Kamion Liaz 110-010	BZ 0445 A	2,000	30	60,000
3	Fadrome Volvo L70C		4,200	30	126,000
4	Kamion Iveco 330-30 H	BZ 0431 A	8,600	30	258,000
5	Kamion Iveco 330-30 H	BZ 0442 A	8,600	30	258,000
6	Kamion Renault CLM 280	BZ 0449 A	7,200	30	216,000
7	Kamion Renault CLM 280	BZ 0421 A	7,000	30	210,000
8	Kamion Renault CLM 280	MT 0262 A	7,200	30	216,000
9	Kamion Renault CLM 280	MT 0342 A	7,200	30	216,000
10	Kamion Iveco 190-30 H	MT 0260 A	5,200	30	156,000
11	Kamion Renault CLM 280	MT 0182 A	7,200	30	216,000
12	Kamion Renault CLM 280	MT 0226 A	7,200	30	216,000

TOTALI	72,534	2,173,218
--------	--------	-----------

Hapi i ankandit do te jete 2 - 5% te vlerës se ofertës me te lartë, i cili do te vendoset nga Komisioni i ankandit, ditën e zhvillimit .

Dokumentat e ankandit do te terhiqen prane Albkrom sh.a. (ne likujdim e siper) me adrese Blloku Vasil Shanto, mbrapa ish KESH Tirane, cdo dite nga e Hena ne te Premte prej ores 10.00 deri 14.00 kundrejt pageses prej 2000 lekë.

Informacione të tjera plotësuese për ankandin mund të merren në të njejtën adresë.

Ankandi do të hapet në datën 11.11.2020 ora 10, në zyrat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomise, në adresën“Bulevardi Dëshmorët e Kombit“ Tiranë, në prani të blerëseve

Lloji i procedurës standarte të ankandit do të jetë: Procedur e Hapur.

Afati i fundit për dorzimin e dokumentacionit, për pjesëmarrje në ankand do të jetë në orën 10-00, të datës 11.11.2020

Kushte e kualifikimit

IV.PJESEMARRJA DHE KUALIFIKIMI

Dokumentat qe duhet te paraqiten

Çdo subjekt fizik apo juridik apo individ do të paraqes në ankand

IV.1 Persona Juridike / Fizike

- a. Kërkesën për blerje.
- b. Formularin e ofertës të plotësuar me shumen dhe vlefshmerine e kerkuar ne DS te Ankandit, te firmosur dhe vulosur me te gjitha gjeneralitetet.
- c. Formularin e sigurimit të ofertës lëshuar nga Banka, për pagesën e 2 % të vlerës fillestare të mallit të kërkuar.
- d. Ekstrakt Historik lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- e. Ekstrakt të Thjeshtë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- f. Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in
- g. Dokument identifikimi te administratorit (fotokopje e noterizuar)
- h. Mandat pagesën për blerjen e dokumentave të ankandit.
- i. Në mungesë të administratorit të shoqërisë për pjesëmarrje në ankand, ky i fundit autorizon me prokurë të posaçme (bashkangjitur ID e noterizuar e perfaqesuesit me prokure) personin që do të marrë pjesë në ankand. I autorizuari duhet të jetë i pajisur me dokument origjinal të identifikimit.
- j. Vertetim qe verteton se subjekti nuk eshte ne proces falimentimi
- k. Vertetim qe subjekti nuk eshte denuar per shkelje penale leshuar nga Gjykata
- l. Vertetim te Gjendjes Gjyqesore
- m. Vertetim qe subjekti nuk eshte ne ndjekje penale per nje nga veprat penale te permendura nga Neni 45, pika 1 e Ligjit per Prokurimet Publike.
- n. Vertetim nga administrata tatimore qe subjekti ka paguar detyrimet e sigurimeve shoqerore

- o. Vertetim nga administrata tatimore qe subjekti ka paguar te gjitha detyrimet fiskale.
- p. Vertetim qe subjekti nuk ka detyrime ndaj Albkrom sh.a. (ne likujdim e siper) te leshuar nga Albkrom sh.a.

IV.2 Individe

- a. Kërkesën për blerje.
- b. Formularin e ofertës të plotësuar me shumen dhe vlefshmerine e kerkuar ne DS te Ankandit, te firmosur me te gjitha gjeneralitetet.
- c. Formularin e sigurimit të ofertës lëshuar nga Banka, për pagesën e 2 % të vlerës fillestare të mallit të kërkuar.
- d. Dokument identifikimi (fotokopje e noterizuar)
- e. Mandat pagesën për blerjen e dokumentave të ankandit.
- f. Vertetim qe individi nuk eshte denuar per shkelje penale leshuar nga Gjykata
- g. Vertetim te Gjendjes Gjyqesore
- h. Vertetim qe individi nuk eshte ne ndjekje penale leshuar nga prokuroria
- i. Vertetim qe individi nuk ka detyrime ndaj Albkrom sh.a. (ne likujdim e siper) te leshuar nga Albkrom sh.a.

Mungesa e njëjës prej dokumentave të cituar më sipër skualifikon kërkuuesin.

V.Specifikimet Teknike.

Janë të përshkruara në DS, “Shtojca” 9.

VI.Fiton ofertuesi qe ka vleren me te larte:

VII.Per fituesit

1. Fituesi i ankandit formularin e sigurimit te kontrates dhe kontraten I nenshkruan sipas Nenit 39 te Ligjit per Ankandet.Fituesi ankandit lidh kontraten per blerjen e mallit pas kryerjes se plote te pageses të mallit sipas vlerës së fituar në ankand duke shtuar dhe 20% e TVSH.
2. Në rast se brënda 30 ditëve, nga data e shpalljes fitues, nuk paguhet vlera e plotë e malli të kërkuar, pagesa prej 2% konfiskohet, gjithashtu , fituesi humbet të drejtën për të marrë pjesë në ankand që do të zhvillohet për rishitjen e këtyre mallrave.
3. Pjesemarrësi ne ankand qe terhiqet pa dhene asnje oferte per vleren e mallrave te shpallura per shitje nuk i kthehet 2% I vleres fillestare i ngurtesuar per pjesemarrje ne ankand
- 4.Pjesemarrësve te tjere ne ankand pervec fituesit ju kthehet 2% i vleres fillestare i ngurtesuar paraprakisht.

Shenim:

Personat juridike apo fizike dhe individet te interesuar per blerjen e mjeteve te transportit te vleresuar si skrap perpara se te paraqiten ne ankand kane te drejten te verifikojne vendndodhjen, sasine dhe cilesine e tyre

ALBMINIERA SH.A.
NJOFTIM ANKANDI

Ne baze te Udhezimit nr.5380, dt.20/07/2011 te M E T E Nxjerrim per shitje me ankand objektin e meposhtem: “Zyra”, Priske e Madhe Tirane

1. Autoriteti shites: “Albminiera sha, Rruga e Kavajes Ish Njesia Bashkiake Nr.7 Kati 3 Tirane,
2. Data e zhvillimit te ankandit: 15.10.2020, ora 11.00
3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit: Ankand i hapur
4. Objekti i Shitjes: “Zyra”, Priske e Madhe Tirane
5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes: Objekti “Zyra” ndodhet në Priske e Madhe Tirane me siperfaqe trualli 415 m2.
6. Vlera fillestare 1 945 633 leke e detajuar si vijon:
Vl. e truallit eshte 188 410 leke, vl. ndertimore 1 757 223 leke.
Vlera fillestare prej 1 945 633 leke do te sherbeje vetem per pagesen prej 2% per pjesmarrje ne ankand.Vlerat jane pa TVSH.
7. Vendi i zhvillimit te ankandit: Ankandi do te zhvillohet ne Ministrine Financave dhe Ekonomise,salla e mbledhjeve.
8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: data 15.10.2020, ora 11.00
9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:
Dokumentet jane bashkengjitur dokumentave standarte.
10. Dokumentat e ankandit mund te terhiqen prane autoriteti shites: Albminiera sha, Rruga e Kavajes Ish Njesia Bashkiake Nr.7 Kati 3 Tirane, Dokumente me pagese. Çmimi 3 000 leke

Dokumentat standarte te ankandit perbehen nga

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesapëroferte;
- Formulari i njoftimit te fituesit;
- Formulari i publikimittenjofitimitefituesit;
- Procesverbali/et i/e KomisionitteVlerësimitteOfertave.

Kerkesa per pjesemarrje,dokumentat dhe informacionet e kerkuara dorzohen nga kandidatet bleres ne kopje fizike me poste ose dorazi ne vendin e percaktuar ne dokumentat e ankandit.

NJOFTIME FITUESI ANKANDI

INSTITUTI I STATISTIKAVE **NJOFTIM FITUESI**

Për: “Nexhmije Hysa”, me NIPT: L91707008E, me adresë: “Rr. Myslym Keta, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë”.

Procedura e ankandit: “Procedurë e Hapur”.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: “Shitje 4 (katër) automjete për skrap”, me vlerë fillestare të ankandit 153.900 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) lekë, pa tvsh, e ndarë sipas loteve më poshtë:

- Loti 1: Autoveturë Land Rover, me targë TR7675A, me numër shasje: SALLJGMFBTA190691 - 47.700 lekë, pa tvsh;
- Loti 2: Autoveturë Opel, me targë TR6310E, me numër shasje: W0L06B0FVYV601018 - 41.400 lekë, pa tvsh;
- Loti 3: Autoveturë Opel, me targë TR0151A, me numër shasje: SED5KMWL4VV607220 - 46.800 lekë, pa tvsh;
- Loti 4: Autoveturë Ford, me targë TR3718L, me numër shasje: WF0AXXGBBAXT80637 - 18.000 lekë, pa tvsh.

Për Lotin 1: Autoveturë Land Rover, me targë TR7675A;

1. “Nexhmije Hysa” L91707008E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 47.700 (dyzet e shtatë mijë e shtatëqind) lekë, pa tvsh;

Për Lotin 2: Autoveturë Opel, me targë TR6310E;

1. “Nexhmije Hysa” L91707008E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 41.400 (dyzet e një mijë e katërqind) lekë, pa tvsh;

Për Lotin 3: Autoveturë Opel, me targë TR0151A;

1. “Nexhmije Hysa” L91707008E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 46.800 (dyzet e gjashtë mijë e tetëqind) lekë, pa tvsh;

Për Lotin 4: Autoveturë Ford, me targë TR3718L;

1. “Nexhmije Hysa” L91707008E
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, pa tvsh;

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Nuk ka ofertues të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Nexhmije Hysa”, me NIPT: L91707008E, me adresë: “Rr. Myslym keta, Njësia Bashkiake Nr. 4, Tiranë”, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 153.900 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) lekë, pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Institutit të Statistikave, me adresë: “Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, të ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.09.2020

Ankesa: Jo

INSTITUTI I STATISTIKAVE

NJOFTIM FITUESI

Për: “HRCP.company”, me NIPT: L81814013I, me adresë: “Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë”.

Procedura e ankandit: “Procedurë e Hapur”.

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: “Shitje letër në sasinë 6150 kg”, me vlerë fillestare të ankandit 20.725 (njëzet mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë, pa tvsh.

Për procedurën e ankandit me objekt “Shitje letër në sasinë 6150 kg”:

1. “HRCP.company”, me NIPT: L81814013I

Vlera totale e ofertës: 24.600 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind) lekë, pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Nuk ka ofertues të skualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “HRCP.company”, me NIPT: L81814013I, me adresë: “Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë”, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 24.600 (njëzet e katër mijë e gjashtëqind) lekë, pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Institutit të Statistikave, me adresë: “Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e ankandit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 39 të Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.09.2020

Ankesa: Jo

UZINA MEKANIKE GRAMSH
NJOFTIM FITUESI

Për : Erlind Elezi P.F., Gramsh ,se oferta e paraqitur nga ana e tij është identifikuar si oferta e suksesshme.

* * *

Procedura e ankandit: Ankand i Hapur

Përshkrim i shkurtër i procedurës së ankandit dhe objektit të tij: Procedura e Ankandit do të zhvillohet nëpërmjet Ankandit të hapur . Shitje me ankand publik e skrapit të bakrit të sekuestruar nga pala debitore:Shoqëria “Alba Demil SH.P.K. dhe skrapit bakri gjendje në administrimin e Uzinës Mekanike Gramsh.Kontrata me ofertuesin fitues do të nënshkruhet brenda 10 ditëve nga shpallja në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ky ofertues me vlerat përkatëse të ofruar:

1. Erlind Elezi “ Person Fizik “	NIPT: L56620803L
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

LOTI I "Shitje skrapit bakri të sekuestruar nga pala debitore:Shoqëria “Alba Demil SH.P.K. ”

Vlera 2,034,320 (dy million e tridhjet e kater mije e treqind e njetete) leke pa TVSH

LOTI II "Shitje skrapit bakri gjendje në administrimin e Uzinës Mekanike Gramsh

Vlera 944,000 (nëntqind e dyzet e kater mije) leke pa TVSH

Është skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1. <u> N.A. </u>	_____
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [ERLIND ELEZI. P.F. GRAMSH] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [LOTI I "Shitje skrapit bakri të sekuestruar

nga pala debitore:Shoqëria “Alba Demil SH.P.K. ”Vlera 2,034,320 (dy million e tridhjet e kater mije e treqind e njezete) leke pa TVSH dhe LOTI II "Shitje skrapu bakri gjendje në administrimin e Uzinës Mekanike Gramsh Vlera 944,000 (nenetqind e dyzet e kater mije) leke pa TVSH] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Uzina Mekanike Gramsh, Gramsh, njesia Adm. Pishaj. Fshati Cekin] kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [LOTI I "Shitje skrapu bakri të sekuestruar nga pala debitore:Shoqëria “Alba Demil SH.P.K. ”Vlera 2,034,320 (dy million e tridhjet e kater mije e treqind e njezete) leke pa TVSH dhe LOTI II "Shitje skrapu bakri gjendje në administrimin e Uzinës Mekanike Gramsh Vlera 944,000 (nenetqind e dyzet e kater mije) leke pa TVSH], siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 25.09.2020

Ankesa: Gramsh, njesia Adm. Pishaj. Fshati Cekin

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

BASHKIA PUKE

Për:Subjektin B.O Ekonomik “Leoni alb”sh.p.k & “Marije Shkambi” perfaqesuar me prokuren e posaçme nr3857 nga subjekti “Marije Shkambi” me adrese Shkoder,Lagjia Skenderbeg,rruga inxh.Gjovalin Gjadri,nr.pasurie 17/188,zona kadastrale nr.8593

Bashkia Puke njofton se ne ankandin e hapur, me dy lote, me objekt Shitje lende drusore dru zjarri., zhvilluar me date 21.09.2020, ora 12.00;

Kane qene pjesmarres ne proçedure vetem nje ofertues me vlerat perkatese te ofruara, per lotin e pare dhe te dyte si me poshte:

1.Subjekti B.O Ekonomik “Leoni alb”sh.p.k & “Marije Shkambi” me nr. NIPT-it K86510003E & K87125005Q , me vlere oferte 1,640,600 Nje milion e gjashteqinde e dyzet mije e gjashteqinde leke pa tvsh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë B.O Ekonomik “Leoni alb”sh.p.k & “Marije Shkambi”. perfaqesuar me prokuren e posaçme nr3857 nga subjekti “Marije Shkambi” me adrese Shkoder,Lagjia Skenderbeg,rruga inxh.Gjovalin Gjadri,nr.pasurie 17/188,zona kadastrale nr.8593 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej - ,640,600 Nje milion e gjashteqinde e dyzet mije e gjashteqinde leke pa tvsh.është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni brenda 10 diteve pranë [Bashkise Puke, Sheshi Terbuni, Nr.1, Puke], siç parashikohet në dokumentat e Ankandit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar(ska), oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bere me date 21.09.2020

Ankesa: Ska patur

KONTRATA TË LIDHURA ANKANDI

ANULLIME ANKANDI

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK **ANULLIM ANKANDI**

Autoriteti Shitës, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), njofton se në ankandin e zhvilluar më datë 17.02.2020, ora 11.00, me objekt “*Shitje e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike*”, me vlerë fillestare të ankandit 53.953 (pesëdhjetë e tremijë nëntëqind pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, sipas Njoftimit të Ankandit, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, Nr. 3, datë 27.01.2020, nuk u paraqit asnjë ofertues.

Sipas Ligjit Nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar, dhe parashikimeve të pikës 6/a të VKM Nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndryshuar, që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në vijim të procedurës së hapur, me përzgjedhje të blerësve duhet të pranohet të paktën 1 (një) ofertë e vlefshme. Në të kundërt, autoriteti shitës ndërpret procedurën dhe fillon një procedurë të re.

Sa më sipër, APP vendosi anulimin e procedurës së ankandit, me objekt: “*Shitje e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike*”. Kjo procedurë do të rishpallet nga AK.

TË TJERA ANKANDE

KREU I KATËRT

Buletini i

ofertave të qirave

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti i Dhënies me qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurimin publik të zhvilluar me datën 24.09.2020, ora 13.⁰⁰, publikimi i të cilit është bërë me datën 14.09.2020 në buletin e njoftimeve publike nr.70 me objekt dhenie me qira:

Loti I: Fillimi i procedurave për dhënien me qira të ekonomisë Pyjore Drin Gjadër Kirë, ngastra nr. 4, 10 në sipërfaqe prej 40.3 ha “Për park fotovoltai” me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite.

Vlera fillestare:

Loti I. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 143,000 leke/ha vit dhe për 40.3 ha është 371 536 lekë në vit në sipërfaqe djerre/inproduktive, e përllogaritur kjo sipas VKM nr. 1064, datë 22.10.2010, lidhja 2.pika 6/1 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Subjekti Ervin Gjini numri i NIPT-it M07122006D

Oferta e paraqitur për Lotin I dhënien me qira të ekonomisë Pyjore Drin Gjadër kirë, ngastra nr. 4, 10, në sipërfaqe prej 40.3 ha “Për park fotovoltai” me afat përdorimi (qiraje), 9 (nente) vite, është 5,762,900 (pese milion e shtateqind gjashtedhjetë e dy mije e nenteqind) lekë në vit pa TVSH.

(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. S’ka të skualifikuar

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

1. Subjektin Subjekti Ervin Gjini

Adresa: Stajkë, Njësia Administrative Bushat, Bashkia Vau Dejës, se oferta e paraqitur, për Lotin I, ekonomia Pyjore Drin Gjadër Kirë, ngastra nr. 4, 10 në sipërfaqe prej 40.3 ha “Për park fotovoltai” me afat përdorimi (qiraje), 9 (nëntë) vite, prej 5,762,900 (pese milion e shtateqind gjashtedhjetë e dy mije e nenteqind) lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejes, me Adresë Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe reference kontakti zyrën e Drejtorisë së Pyjeve, Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.09.2020
Ankesa , S'ka

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti i Dhënies me qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurimin publik të zhvilluar me datën 25.09.2020, ora 13.⁰⁰, publikimi i të cilit është bërë me datën 14.09.2020 në buletin e njoftimeve publike nr.70 me objekt dhenie me qira:

Loti I: Fillimi i procedurave për dhënien me qira të ekonomisë Pyjore Gomsiqe, ngastra nr. 12/b, 13 në sipërfaqe prej 1.037 ha “Për qellime pushimi, argetimi” me afat përdorimi (qiraje), 5(pesë) vite.

Vlera fillestare:

Loti I.Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 90,000 leke/ha vit dhe për 1.037 ha është 93,330 lekë në vit në sipërfaqe cunqishte, shkurre e përllogaritur kjo sipas VKM nr. 1064, datë 22.10.2010, lidhja 2.pika 6/1 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

Njoftojme se, ka qenë pjesëmarrës në procedure ky ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Subjekti Ramazan Daija numri i NIPT-it M07114002A

Oferta e paraqitur për Lotin I dhënien me qira të ekonomisë Pyjore Gomsiqe, ngastra nr. 12/b, 13, në sipërfaqe prej 1.037 ha “Për qellime pushimi, argetimi” me afat përdorimi (qiraje), 5(pesë) vite, është 93,330 (nëntëdhjetë e tremije treqindë tridhjetë) lekë në vit pa TVSH.

(me numra dhe fjale)

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. S'ka të skualifikuar
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

1. Subjektin Subjekti Ramazan Daija

Adresa: Shkoder Vau Dejes Gomsiqe Milloje, Rr. Komanit, nr. pasurie 319/320, zona kadastrale 2097, Bashkia Vau Dejes, se oferta e paraqitur për Lotin I, ekonomia Pyjore Gomsiqe, ngastra nr. 12/b, 13 në sipërfaqe prej 1.037 ha “Për qellime pushimi, argetimi” me afat përdorimi (qiraje), 5(pesë) vite, prej 93,330 (nëntëdhjetë e tremije treqindë tridhjetë) lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejes, me Adrese Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe reference kontakti zyrën e Drejtorisë së Pyjeve, Turizmit, Kulturës dhe Mjedisit

,kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike nr.9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.09.2020.
Ankesa , S'ka

BASHKIA MALIQ **NJOFTIM PER DHENIE ME QERA**

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për caktimin e kriterëve, të procedurës të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar, kreu II, pika 4 dhe pika 5, Udhëzimi nr. Udhëzimi nr.6756, datë 03.09.2015 “Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, Vendimit Nr. 5, datë 20.03.2019 të Këshillit Mbikqyrës të “Kombinatit të Sheqerit” Sh.A Maliq , Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.62, datë 24.08.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë Nr.789/3 prot, datë 02.09.2020 të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me nr.4145/1, datë 15.09.2020, Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr.442, datë 07.10.2020 “Për fillimin e procedurës për dhënie me qira”,

1- Të dhënat e pasurisë që do të jepet me qira:

- | | |
|---|--|
| a. Emertimi
në zonën | - “Pasuritë shtetërore me nr.1/250, nr.1/231, nr.1/248, 1/237

kadastrale 2573, në Kombinatin e Sheqerit Sh. A Maliq”
(sipas skicës bashkëngitur Vendimit të Këshillit Mbikqyrës) |
| b. Sipërfaqja e objektit | - 4.891.1 (katërmije e tetëqindënëntëdhjetënjë pikë një) m ² |
| c. Qëllimi i përdorimit
frigoriferëve, mjedise | - Investim në ndërtimin e fabrikave të përpunimit,

ndihmëse për ushtrimin e aktivitetit |
| d. Vlera dysheme e qirase mujore për sipërfaqen e objektit | sipas VKM nr.54, datë 05.02.2014, i ndryshuar
Aneksi A është (75 lekë/m ²). |
| e. Për truallin e ndërtesës (objekti) qiraja përfshihet në tarifën e qirasë të ndërtesës; | |
| f. Afati i dhënies me qira: | 20 (njëzetë) vjet |
| g. Veprimtaria që do të ushtrohet në objekt: | “Investim në përpunimin aktiv të mallrave” |

2- Pikët vlerësuese për elementët e konkurimit sipas pikës 3 dhe 4 kreu të I-rë të jenë :

- | | |
|---------------------------------------|---------|
| a. Niveli i investimit | 35 pikë |
| b. Niveli i të punësuarëve | 35 pikë |
| c. Oferta e detyrimit mujor të qërasë | 20 pikë |
| d. Gjëndja e llogarisë në bankë | 10 pikë |

- 3- Dokumentacioni i konkurrenteve do te paraqitet:
- a) Vendi - Zyra e protokollit , Kati i I-rë, Bashkia Maliq
 - b) Data - 22.10.2020
 - c) Ora - 10^{oo}
- 4- Konkurrentët e interesuar për marrjen me qira të objektit: “Pasuritë shtetërore me nr.1/250, nr.1/231, nr.1/248, 1/237 në zonën kadastrale 2573, në Kombinatin e Sheqerit Sh. A Maliq” me sipërfaqe totale 4.891.1 (katërmije e tetëqindënëntëdhjetënjë pikë një) m² duhet të plotësojnë këtë dokumentacion:
- a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.
 - b) Plan-biznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
 - Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
 - Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
 - Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër;
 - c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
 - Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS te subjektit kërkues;
 - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
 - Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
 - Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteoze në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksoj se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
 - Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.
 - d) Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të lëshuar brenda 15 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të ofertave.
 - e) Vërtetim nga Prokuroria që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin, të lëshuar brenda 15 ditëve nga afati i fundit i dorëzimit të ofertave
 - f) Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësisive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin 2020 sipas ekstraktit të regjistrit tregëtar.

KONCESIONE / PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT

PROCEDURA KONKURRUESE PËR **LEJE MINERARE**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **NJOFTIM FITUESI**

Nr.i Referencës: Zona Minerare Nr. 639/1, për objektin Kasaj - Kamenicë, Tropojë, Qarku Kukës, lloji mineralit krom, veprimtaria kërkim - zbulim, e miratuar në planin vjetor mineral të vitit 2018. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë “EMB” sh.p.k, me NUIS L99217602U, me adresë: Lagjia “Kasaj”, Rr. “Trojet”, Tropojë, se oferta e paraqitur më datë 05.08.2020, për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 639/1, për vlerën totale të investimit prej 17 000 000 [shtatëmbëdhjetë milion] lekë dhe vlerën e investimit për punime minerare gjeologjike 75 %, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 639/1, për objektin Kasaj - Kamenicë, Tropojë, Qarku Kukës, lloji mineralit krom, veprimtaria kërkim - zbulim, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

- Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer 17 000 000 lekë
- Vlera e investimit për punime minerare gjeologjike 75 %

Ofertuesi shoqëria “EMB” sh.p.k kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. “Abdi Toptani” Nr. 1 – Tiranë:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendrike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **NJOFTIM FITUESI**

SHOQËRISË “ALION” SH.P.K

Lagjia “Uznovë”, Rruga nacionale Berat – Poliçan, Berat

Nr.i Referencës: Zona Minerare Nr. 347/6, për objektin Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, lloji mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim, (ish leje minerare nr. 1107).

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë “Alion” sh.p.k, me NUIS K32803014D, me adresë: Lagjia “Uznovë”, Rruga nacionale Berat – Poliçan, Berat, se oferta e paraqitur më datë 05.08.2020, për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 347/6, për vlerën totale të investimit prej 41 500 000 [dyzetë e një milion e pesqind

mijë] lekë dhe sasinë e prodhimit të mineralit gëlqeror pllakor 7 000 [shtatë mijë] m³/vit, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 347/6, për objektin Krahës, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, lloji mineralit gëlqeror pllakor, veprimtaria shfrytëzim, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

- | | |
|--|---------------------------|
| • Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare | 7 000 m ³ /vit |
| • Sasia e prodhimit që do të përpunohet | 7 000 m ³ /vit |
| • Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer | 41 500 000 lekë |
| • Vlera e produkteve minerare | 3 338 128 000 lekë |
| • Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=....%) | 49 % |

Ofertuesi shoqëria “Alion” sh.p.k kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. “Abdi Toptani” Nr. 1 – Tiranë:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **NJOFTIM FITUESI**

SHOQËRISË “CR - 4” SH.P.K

Sheshi “Murat Zhaboli”, Krastë, Martanesh, Dibër

Nr.i Referencës: Zona Minerare Nr. 591/1, për objektin Përroi i Lopsit, Bulqizë, Qarku Dibër, lloji mineralit krom, veprimtaria kërkim - zbulim, (ish leje minerare nr. 1702).

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë “CR - 4” sh.p.k, me NUIS L46315702I, me adresë: Sheshi “Murat Zhaboli”, Krastë, Martanesh, Dibër, se oferta e paraqitur më datë 05.08.2020, për përfitimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 591/1, për vlerën totale të investimit prej 4 500 000 [katër milion e pesqind mijë] lekë dhe vlerën e investimit për punime minerare gjeologjike 75 %, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 591/1, për objektin Përroi i Lopsit, Bulqizë, Qarku Dibër, lloji mineralit krom, veprimtaria kërkim - zbulim, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

- | | |
|--|----------------|
| • Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer | 4 500 000 lekë |
| • Vlera e investimit për punime minerare gjeologjike | 75 % |

Ofertuesi shoqëria “CR - 4” sh.p.k kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. “Abdi Toptani” Nr. 1 – Tiranë:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.

NJOFTIME TË TJERA

DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR KUKËS

Njoftim per vend te lire pune

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukës , shpall 1 vend te lire pune si me poshte :

1- Shofer Autoambulance

KRITERET KRYESORE TE PUNESIMIT

- Te kete perfunduar arsimin e mesem
- Te jete i pajisur me lejen drejtimi per autoambulance (Klasi D)
- Eksperienca ne pune eshte avantazh
- Te jete komunikues dhe i afte te punoje ne grup

KANDIDATET DUHET TE PARAQESIN KETO DOKUMENTA

- Kerkese me shkrim per aplikim
- C.V
- Fotokopje e noterizuar e defteses .
- Fotokopje e noterizuar te lejes drejtimit te automjetiti (autoambulance Klasi D).
- Dokumentin e identitetit dhe vertetimin e vendbanimit
- Raport mjeko-ligjor
- Dëshmi penaliteti(vertetim prokurori dhe gjykate)
- Libreze pune
- Vleresim pune nga punedhenesit e meparshem (nese ka).

Mos paraqitja e te gjitha dokumentave te kerkuara ne original ose ne fotokopje e noterizuar e skualifikon automatikish kandidatin .

Per ata qe duan te konkurojne , dokumentat duhet te paraqiten prane Drejtorise Sherbimit Spitalor Kukës (Zyra e Burimeve Njerezore) 5 dite pas botimit te ketij njoftimi ne buletin. Konkurimi do te behet prane Drejtorise Sherbimit Spitalor Kukës.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Blerje e suportit vjetor të produkteve Checkpoint”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,100,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Blerje e suportit vjetor të produkteve Checkpoint”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 30 Tetor 2020, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË
TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 2,000,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 27 Tetor 2020, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BANKA E SHQIPËRISË **TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: “Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të disa pajisjeve UPS të dhomave të serverëve të Bankës së Shqipërisë”.

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,577,000 Lekë”.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 214), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të kenë bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë

BIC: STANALTR

IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të disa pajisjeve UPS të dhomave të serverëve të Bankës së Shqipërisë”

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 02 Nentor 2020, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

FAKULTETI I EKONOMISË **Njoftim per vend te lire pune**

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, rishpall konkursin për Personel Administrativ për **1 (një) vend pune në emërtesën “Punëtor Mirëmbajtje (Elektriciist)”**.

Kandidatët konkurrentë për pozicionin **“Punëtor Mirëmbajtje (Elektriciist)”** duhet të plotësojnë kriteret e poshtëcituara:

Kritere të përgjithshme:

1. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë.
3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
4. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kriteret të vecanta:

5. Të ketë diplomën e arsimit të mesëm.
6. Të zotërojnë dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik "Elektriciist".
7. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dijë të punojë në grup.
8. Preferohet të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë pune në profesionin elektriciist.

Sistemi i vlerësimit është i përbërë prej 100 pikësh, të ndara në: Testimi me shkrim 50 pikë, Dokumentet e dorëzuara 15 pikë dhe Intervista e strukturuar me gojë 35 pikë.

Intervista e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve do të bëhet nga Komisioni i ngritur nga Administratori i Fakultetit të Ekonomisë në gjuhën Shqipe. Intervista do të fokusohet në formimin e përgjithshëm, eksperiencat e kandidatit.

Kandidatët që do të aplikojnë për **“Punëtor Mirëmbajtje (Elektriciist)”** duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Jetëshkrim (CV).
3. Fotokopje e dokumentit të identifikimit.
4. Fotokopje e diplomës së shkollës së mesme të noterizuar.
5. Fotokopje e librezës së punës (në të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar.
6. Dokument tjetër që vërteton trajnime, kualifikimet, arsimin shtesë etj., (nëse ka).
7. Dëshmi penaliteti ose formular vetdeklarimi.
8. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore.
9. Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.
10. Dëshmi për kualifikimin e sigurimit teknik “Elektriciist”.

Dokumentacioni i mësipër do të dorëzohet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, duke filluar nga data 12.10.2020 – 26.10.2020.

UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

Njoftim per vend te lire pune

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Psikologjisë dhe punës sociale, në pozicionin lektor/e ose asistent-lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2020-2021 për lëndët “Probleme sociale” dhe “Puna sociale me grupet dhe komunitetet”, në ciklin e parë të studimeve Bachelor në Punë sociale.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret specifike :

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e shkollimit me kohë të plotë në specialitetin “Punë sociale”.
2. Të kenë kryer ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në degën “Punë sociale” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5.
3. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” me drejtim Punë sociale me notë mesatare jo më të ulët se 9.
4. Të kenë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i shkencave” (Diplomë e sistemit 4-vjeçar) dhe DIND (300 kredite në total) në profilin Punë sociale me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
5. Të kenë noten mesatare të lëndëve për të cilat konkurrojnë mbi 9.
6. Të kenë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja të BE-së me notë jo më të ulët se 8 ose të njohur nga kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin B2.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme :

1. Të kenë aftësi të punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
2. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

4. Të mos jenë larguar nga USH “L.Gurakuqi” pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH “L.Gurakuqi”.
6. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo krushqie (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës egzistues brenda të njëjtes njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :

1. Të aplikojë “on-line” në faqen zyrtare të USH në internet në adresen www.unishk.edu.al (rubrika lidhje të shpejta)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
